



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 64, datë 22/12/2004

**“MBI NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2004  
TË NJËSISË BASHKIAKE Nr.5 ”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 19/9 dhe neni 32/dh, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 “Për buxhetin lokal”, neni 18, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, ligjit Nr.8654, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës” neni 6, pika 2 dhe 4, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit për vitin 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2004”, bazuar në kërkesën e Njësisë Bashkiake Nr.5, Nr.640/1, dt.02/11/2004 dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I;**

1. Të miratojë një shtesë në buxhetin e vitit 2004 të Njësisë Bashkiake Nr.5 për investime në shumën prej 1.000.000 lekësh, për objektin “Kanalizimi i ujrave të zeza, Pallatet 1 Maji”.
2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij Vendimi do të përballohen duke pakësuar fondin e investimeve të vitit 2004 të Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, zëri “Blerje pajisjesh për Çerdhet” në shumën 1.000.000 lekësh.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Njësia Bashkiake Nr.5 dhe Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**